

HIGJIENA NË SHKOLLAT DHE ÇERDHET E PRISHTINËS NË KOHË PANDEMIE

RAPORT NGA MONITORIMI I TENDERIT
PËR FURNIZIM ME MATERIALE HIGJENIKE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE





HIGJIENA NË SHKOLLAT DHE ÇERDHET E PRISHTINËS NË KOHË PANDEMIE

**RAPORT NGA MONITORIMI I TENDERIT PËR FURNIZIM
ME MATERIALE HIGJENIKE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE**

Monitorues dhe autor: Arbelina Dedushaj

Fasilitator: Visar Prebreza

Dizajni grafik: Fleta Baraku

PËRMBAJTJA

- 7 **Hyrje**
- 7 **Metodologjia**
- 8 **Fazat dhe për zgjedhja e fituesit për furnizim me materiale higjienike**
- 8 **Ndikimi i pandemisë në zbatimin e kontratës**
- 9 **Lista e institucioneve arsimore për furnizim**
- 10 **Takimet në shkolla**
- 12 **Përfundime dhe rekomandime**
- 13 **Infografika**



Demokrasi Plus (D+) është organizatë joqeveritare që bashkon persona me besim të fuqishëm në vlera demokratike dhe në një Kosovë me demokraci të qëndrueshme. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që stimulojnë aktivizimin qytetar. Në kuadër të D+ funksionojnë tri programe: Programi për Qeverisje të Mirë, Programi për Sundim të Ligjit, dhe Programi për Zgjedhje dhe Parti Politike. D+ përkrahë institucionet qeveritare, qytetarët dhe mediat në përmirësimin e qeverisjes, avancimin e politikave publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit. Organizata jonë përqendrohet në përdorimin e teknologjisë informative për qëllimet e lartshënuara, dhe si rezultat ka zhvilluar platformat online *ndreqe.com* dhe *qeverisjatani.info*, të cilat ofrojnë hapësirë për pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje dhe llogaridhënie të institucioneve qeveritare. Për më tepër, D+ është anëtare e ProOpen, koalicioni i OJQ-ve që ka për qëllim ngritjen e transparencës në prokurim publik dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike.

Hyrje

Viti 2020 nuk ishte i lehtë as për qytetarët e Kosovës e as për vendimmarrësit. Situatat e papritura të krijuara nga COVID-19 kanë çakorduar edhe mbarëvajtjen e mësimdhënies, me rastin e mbylljes së të gjitha institucioneve arsimore. Pavarësisht kësaj, Komuna e Prishtinës më 1 prill të këtij viti kishte hapur tender për furnizim me materiale higjienike, pasi kontrata paraprake veç kishte skaduar.

Pavarësisht vendimit të Qeverisë së Kosovës¹, për t'i mbajtur të mbyllura shkollat, iniciimi i procedurës për blerjen e produkteve higjienike ka qenë në fakt vendim i duhur i komunës, meqë edhe ashtu kontrata paraprake veç kishte skaduar, derisa edhe vendimet dhe masat lidhur me situatën ndryshonin nga dita në ditë.

Demokrati Plus (D+) në këtë raport ka paraqitur rëndësinë e një tenderi të tillë në një situatë ku pandemia e virusit korona ka përfshirë gjithë botën. Pavarësisht pengesave gjatë rrugës, D+ ka bërë monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate.

Pra, ky raport flet edhe për fazën e përzgjedhjes së fituesit, por më shumë përqendrohet te zbatimi i saj. Po ashtu në raport përmenden edhe disa parregullsi te produktet dhe çmimi i tyre.

Metodologjia

Gjatë procesit të monitorimit të tenderit “Furnizim me materiale higjienike për institucionet arsimore” me numër të prokurimit 616-20-1092-1-2-1, D+ ka analizuar dokumentet që nga njoftimi për kontratë deri te furnizimi me materialet e tenderuara. Në vendimin për përzgjedhjen e këtij tenderi ka ndikuar edhe pandemia COVID-19, meqë rëndësi e dorës së parë në këtë kohë është higjiena dhe mbrojtja e shëndetit publik.

Në këtë drejtim, nxënësve duhet t'u sigurohen produkte dhe materiale të bollshme higjienike, sidomos në këtë kohë. Andaj, D+ është takuar edhe me zyrtarët e prokurimit dhe menaxherët e kontratës. Përveç kësaj, D+ ka vizituar disa shkolla të cilat janë në listën e komunës për t'u furnizuar më këto materiale të domosdoshme.

Pjesë e metodologjisë së këtij raporti është edhe krahasimi, me ç'rast janë krahasuar çmimet e fituesit të kontratës me çmimet e tregut. Nga ky krahasim është gjetur se të njëjtat çmime janë ofruar me çmim jo normalisht të ulëta.

¹ <https://kallxo.com/lajm/vendimi-i-qeverise-se-kosoves-mbylljen-shkollat-deri-me-27-mars/>

Fazat dhe përzgjedhja e fituesit për furnizim me materiale higjienike

Më 1 prill 2020, Komuna e Prishtinës kishte publikuar njoftimin për kontratë me titullin “Furnizim me material higjienik për institucionet arsimore”, kontratë kjo kornizë për vetëm një operator ekonomik. Për këtë tender, komuna kishte planifikuar buxhet prej 50 mijë eurosh, ku kishin ofertuar pesë operatorë ekonomikë, por çmimin më të lirë e kishte ofruar El Shpëtimi, e cila është edhe fituese dhe zbatuese e kontratës. Çmimi total i ofertës së kompanisë El Shpëtimi bashkë me TVSh është 38,126.70 euro, ndërsa oferta më e shtrenjtë ishte ajo e operatorit ekonomik Beni Dona, me 59,758.70 euro.

Më 15 maj 2020, AK-Komuna e Prishtinës kishte publikuar emrin e fituesit El Shpëtimi përmes njoftimit për dhënien e kontratës, ku në të njëjtën ditë edhe është nënshkruar kontrata dhe është publikuar njoftimi për nënshkrim të kontratës. Mirëpo, në kontratën e publikuar në e-prokurim, data e nënshkrimit të kontratës është shkruar gabim (13.05.2020), kur në fakt në këtë ditë ende nuk ishte publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Përveç kësaj, pavarësisht që kontrata ka hyrë në fuqi para rreth tre muajve, AK ende nuk ka bërë asnjë porosi, gjë që tregon për zbatim të dobët të kontratës.

Ndikimi i pandemisë në zbatimin e kontratës

Arsyeja e përzgjedhjes së këtij tenderi është bazuar edhe në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19. Kjo epokë, ta quajmë kështu, ka krijuar nevojën për shtimin e kujdesit ndaj higjienës dhe mirëmbajtjes së shëndetit publik, andaj marrë parasysh këtë fakt është bërë edhe kjo përzgjedhje. Në fakt, pandemia në zbatimin e kësaj kontrate përveç rëndësisë që i ka dhënë furnizimit me produkte higjienike, në anën tjetër e njëjta situatë e ka vështirësuar zbatimin e saj, meqë është çrregulluar mbarëvajtja e mësimdhënies.

Pavarësisht kësaj, institucionet arsimore është dashur ta bëjnë porosinë te kompania fituese dhe të pajisen me produkte higjienike, meqë produktet si të tilla nuk dëmtohen për një periudhë të gjatë kohore.

Duhet shtuar se rëndësia e bërjes së porosive të tilla ka qenë edhe për shkak të organizimit të testimit të maturantëve, ku MASH-ti, pavarësisht situates, kishte marrë vendim për ta mbajtur pikërisht më 29 gusht 2020.

Kjo ministri, kishte theksuar se komunat kanë bërë përgatitjet e duhura për këtë testim, përgatitje këto që kanë të bëjnë me dezinfektimin e objekteve, furnizimin me materiale mbrojtëse, sanitare e higjienike. Për këtë proces, MASH ka bërë të ditur se është në koordinim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike².

Si duket ndikimi që ka shkaktuar e gjithë kjo periudhë që nga paraqitja e rastit të parë në Kosovë, është rrënjësor dhe të paktën edhe për një kohë nuk vërehen shenja të normalizimit të tërësishtëm. Pos kësaj, shtimi i kujdesit dhe thirrjet për mbajtjen e pastërtisë është dashur të jenë alarm sidomos për institucionet ku po rriten gjeneratat e reja.

² <https://www.epokaere.com/testi-i-matures-mbahet-me-29-gusht/>

Lista e institucioneve arsimore për furnizim

Nga Komuna e Prishtinës, D+ ka marrë listën e institucioneve arsimore të cilat do të furnizohen nga kompania El-Shpëtimi. Në këtë listë janë përfshirë pothuajse të gjitha shkollat e mesme të larta, shumica e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe të gjitha institucionet parashkollore -çerdhet brenda komunës. Në këtë tender nuk janë përfshirë disa institucione arsimore nga kjo kategori dhe kopshtet që janë me bazë në komunitet, kjo pasi disa prej tyre furnizohen nga kontraktuesë të tjerë.

D+ ka kërkuar nga menaxheri i kontratës, Fatlum Osmani, informacione se cilat institucione janë furnizuar gjatë kohës së shkrimit të këtij raporti. I njëjti më 3 korrik 2020 është përgjigjur se ende asnjë nga institucionet arsimore të listuara më poshtë nuk janë furnizuar. D+ sërish ka kërkuar të njëjtin informacion nga z.Osmani, e atë më 28 gusht 2020, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Andaj më poshtë janë listuar vetëm institucionet arsimore që priten të furnizohen me këtë kontratë.

Shkollat e mesme të larta	Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta	Institucionet parashkollore dhe çerdhet	Materialet higjienike	Dita e furnizimit
28 Nëntori	Asim Vokshi	Gëzimi Ynë	x	x
Abdyl Frashëri	Elena Gjika	Dielli	x	x
Gjimnazi Matematikor	Emin Duraku	Fatosat	x	x
Prenk Jakova	Faik Konica	Yllkat	x	x
Ahmet Gashi	Gjergj Fishta	Ardhmëria	x	x
Alauddin	Hasan Prishtina	Xixëllonjat	x	x
Xhevdet Doda	Ismail Qemaili	Buzëqeshja	x	x
Ali Sokoli	Iliria	Lulevera	x	x
Sami Frashëri	Meto Bajraktari		x	x
Gjin Gazulli	Nazim Gafurri		x	x
Hoxhë Kadri Prishtina	Zenel Hajdini		x	x
7 shtatori	7 marsi		x	x
Eqrem Çabej	Xhemail Mustafa		x	x
	Hilmi Rakovica		x	x
	Azemi e Salihu		x	x
	Avni Rrusemi		x	x
	Anton Z. Çajupi		x	x
	Ali Kelmendi		x	x
	Dituria		x	x

	Ditët e Minatorit		x	x
	Dëshmorët 1921		x	x
	Fan S. Noli		x	x
	Filip Shiroka		x	x
	Ganimete Tërbeshi		x	x
	Isa Boletini		x	x
	Mitrush Kuteli		x	x
	Nënë Tereza		x	x
	Nexhmi Mustafa		x	x
	Rilindja		x	x
	Shkëndija		x	x
	Teuta		x	x
	Tefik Çanga		x	x
	Pavarësia		x	x
	Xhavit Ahmeti		x	x
	Afrim Gashi		x	x

Tabela 3. Tabela me institucione arsimore të cilat duhet të furnizohen me materiale higjienike sipas kontratës

Takimet në shkolla

Për shkak të natyrës së kontratës dhe në kuadër të metodologjisë për monitorimin e zbatimit të së njëjtës, D+ ka vizituar më 24 korrik 2020 dy shkolla të mesme, shkollën “Sami Frashëri” dhe “Abdyl Frashëri”. Qëllimi i vizitës në këto shkolla ishte informimi nëse të njëjtat janë furnizuar me materiale higjienike dhe nëse këto materiale i përmbajnë të gjitha specifikat sipas dosjes së tenderit, në bazë të së cilave edhe është nënshkruar kontrata.

Meqë të njëjtat ende nuk ishin furnizuar nga kompania fituese, vizita u fokusua vetëm te materialet higjienike që i kanë aktualisht, pikërisht për shkak se maturantët do të kthehen në shkolla në gusht për t’iu nënshtruar testit të maturës.

Në shkollën “Sami Frashëri”, D+ është takuar me drejtorin Fetah Zejnullahu. I njëjti është shprehur se kërkesën në Komunën e Prishtinës e ka dorëzuar më 9 maj 2020, por nuk i ka pranuar ende këto materiale. Për shkak të mungesës së shtëpiakut, drejtori Zejnullahu nuk pati mundësi të na i tregojë materialet higjienike që i posedon momentalisht shkolla, përveç disa materialeve dezinfektuese si: dezinfektues, alkool për pastrimin e bankave shkollore dhe doreza.

Ndërsa, në shkollën “Abdyl Frashëri”, D+ është takuar me drejtorin e saj, Bekë Mulaj. I njëjti

prezantoi të gjitha rezervat që kanë nga kontrata e kaluar, ku furnizimi i fundit ishte kryer gjatë muajve janar-shkurt, para se të mbyllet gjithçka për shkak të pandemisë COVID-19. Mulaj tregoi që nuk ka bërë ende kërkesë në komunë meqë shkollat janë mbyllur e materiale higjienike ka mjaftueshëm. Mirëpo, i njëjti theksoi se, varësisht nga situata do t'i bëjë edhe porositë. Gjithashtu, ai tregoi se ka edhe materiale dezinfektuese, por që sipas tij me siguri do të furnizohen me mjete shtesë për ditët kur do të organizohet testi i maturës.

Kompania fituese e tenderit për furnizim me materiale higjienike, El Shpëtimi ka ofertuar me çmime që nuk përrupthen me çmime të tregut apo më saktë çmime këto që janë shumë më të lira sesa ato të tregut. Sipas Rregullave për Tenderë Jonormalisht të Ulët³, çmimi total i El Shpëtimi nuk është jonormalisht i ulët, mirëpo nëse marrim çmimet e produkteve veç e veç, do të vërejmë diferenca të mëdha në mes këtyre çmimeve dhe atyre të tregut.

Çmime të tilla mund të përmendim te produktet: shamponi për enë, ku për një litër fituesi i kontratës ka ofertuar 0.60 euro, ndërsa në treg, çmimi i të njëjtit produkt shkon deri në 1.50 euro.

Çmim tjetër me këtë dallim është te telat për enë, ku fituesi për një tel ka ofertuar vetëm 0.07 euro, ndërsa i njëjti në treg ka çmim rreth 30-40 euro. Sigurisht çmimet pastaj variojnë edhe sipas markës së produkteve përkatëse. Po ashtu sfungjerët për enë janë ofertuar me 0.10 euro, ku të njëjtat blihen në treg me çmim rreth 0.50 euro.

Një prej produkteve me të shtrenjta në këtë listë, është tharësja për duar me sensor, e njëjta ishte ofertuar me 40 euro, ku ishte llogaritur të porositeshin 180 të tilla. Mirëpo, e njëjta mund të gjendet në treg edhe me 25 euro⁴.

Çmim tjerët që ka ndryshim të madh është edhe kova për xhokër e cila në kontratë është ofertuar vetëm për 0.80 euro.

Një parregullsi tjetër në këtë tender është edhe përcaktimi i emrit të markës së produktit, gjë që është e ndaluar me legjislacionin e Kosovës. Kjo realisht është përshtatje e kriterëve dhe automatikisht përjashton kompanitë tjera që nuk e ofrojnë produktin përkatës.

Një prej markave të përmendura është "Fresh", gjë që është e ndaluar me legjislacion për prokurim publik. Kjo markë është kërkuar për shamponin e duarve, e atë 4,000 copa, e cila është ofertuar me 0.50 euro, ndërsa në treg e njëjta kushton 1.15 euro.

³ Neni 3 i Rregullave për Tenderët Jonormalisht të Ulët.

⁴ <https://m.facebook.com/daytodayks/posts/165332708364551>

Përfundime dhe rekomandime

Lidhja e shpeshtë e kontratave për furnizim me materiale higjienike, bën që shpesh, të njëjtat mos të kenë vëmendjen e shoqërisë civile. Mirëpo, rëndësia e monitorimit të tyre erdhi në pah në kohën kur higjiena u bë kryefjalë që nga fillimi i pandemisë COVID-19.

Në këtë drejtim, institucionet duhet të kenë për bazë kohën e saktë të fillimit të procedurave të prokurimit në rastet e përfundimit të kontratave paraprake, si dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave me përpikëri dhe duke e respektuar legjislacionin e prokurimit publik të Kosovës.

Në pajtim me të gjeturat dhe analizimin e tenderit për furnizim me materiale higjienike për institucionet arsimore, kontratë kjo e lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe operatorit ekonomik El Shpëtimi, e njëjta komunë rekomandohet të bëjë:

- Vlerësimin paraprak të nevojave lidhur me materialet higjienike;
- Takime me institucionet arsimore lidhur me këto nevoja;
- Analizimin e çmimeve të tregut të të gjitha produkteve që planifikohen të blihen përmes kontratës;
- Përpilimin e specifikave në mënyrë sa më të detajuar të çdo produkti që planifikohet të blihet;
- Vlerësimin dhe ekzaminimin e çmimeve për njësi;
- Shmangien e kërkesave që lidhen me marka (brende) të caktuara.

MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS HIGJIENA NË SHKOLLAT DHE ÇERDHET E KOMUNËS SË PRISHTINËS NË KOHË PANDEMIE



Në tenderin **“Furnizim me materiale higjienike për institucionet arsimore”** me numër të prokurimit 616-20-1092-1-2-1 kanë marrë pjesë pesë ofertuesë. Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur.**



Për këtë tender, **Komuna e Prishtinës kishte shpallur fitues operatorin ekonomik El Shpëtimi**, kontratë kjo me vlerë prej 38,126.70 €.



Sipas kontratës, furnizimi duhet të bëhet në pothuajse të gjitha shkollat e mesme të larta, në shumicën e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe të gjitha institucionet parashkollore apo çerdhet brenda komunës.



Te një nga produktet, **komuna ka kërkuar markën Fresh, por përmendja e një brendi të caktuar është e ndaluar me Ligjin për Prokurimin Publik.** Një gjë e tillë, eliminon apo redukton konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.



Gjithashtu, **El Shpëtimi ka ofertuar çmime shumë më të lira sesa ato të tregut.** Në këso raste, problemet paraqiten te zbatimi i kontratës dhe cilësia e produkteve.



Krahasimi i çmimeve të kontratës me ato të tregut:

- Për një litër **shampon për enë**, El Shpëtimi ka ofertuar me 0.60 €, ndërsa në treg, i njëjti produkt me të njëjtën sasi blihet për rreth 1.50 €.

- **Sfungjerët për enë** janë ofertuar me 0.10 €, por të njëjtit blihen në treg me çmim prej rreth 0.50 €.

- Çmim tjetër që dallon është edhe ai i **telave për enë**. El Shpëtimi ia ka shitur Komunës së Prishtinës vetëm për 0.07 €, ndërsa në treg gjendet me 0.30-0.40 €.



Demokrati Plus ka vizituar dy shkolla të mesme, shkollën “Sami Frashëri” dhe “Abdyl Frashëri” dhe **është konstatuar që të njëjtat, në kohën kur është bërë hulumtimi, nuk kanë qenë të furnizuara me materialet e kontratës së re nga kompania fituese.**



REKOMANDIME

Në pajtim me të gjeturat dhe analizimin e tenderit për furnizim me materiale higjienike për institucionet arsimore, i rekomandohet Komunës së Prishtinës të bëjë:

Vlerësimin paraprak të nevojave lidhur me materialet higjienike;

Analizimin e çmimeve të tregut të të gjitha produkteve që planifikohen të blihen përmes prokurimit publik;

Përpilimin e specifikave në mënyrë sa më të detajuar të çdo produkti që planifikohet të blihet;

Vlerësimin dhe ekzaminimin e çmimeve për njësi;

Shmangien e kërkesave që lidhen me marka (brende) të caktuara.

Periudha e monitorimit maj - shtator 2020.

